



Ky test ka për qëllim të vlerësojë njohuritë e juaja lidhur me politikën për mbrojtjen e fëmijëve në HANDIKOS. Testi përbëhet nga 12 pyetje, nga të cilat disa janë me zgjidhje të shumëfishta. Pyetjet janë relevante me materialin që ju keni përcjellur paraprakisht.

Shkalla e kalueshmërisë së testit është 80%, ndaj ju lusim të shfrytëzoni kohën në dispozicion për të reflektuar mbi materialin e prezantuar për ju më parë.

Nëse kaloni pragun minimal, ju do pranoni njoftimin zyrtar nga HANDIKOS për të vazhduar tutje me procedurat në vazhdim.

Emri dhe Mbiemri _____

Email adresa _____

Pozita _____

1. Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve në HANDIKOS ka për qëllim: (shumëfishtë)

- Rritjen e sensibilizimit mbi çështjet e abuzimit;
- Udhëzimin rreth parandalimit dhe trajtimit të rasteve të abuzimit;
- Kufizimin e mundësisë së abuzimit, përmes rekrutimit të sigurt të stafit dhe kulturës së hapur dhe informimit
- Abuzimin ndaj fëmijëve
- Të gjitha më lart

2. Rretho opsionin që paraqet saktë 5 kategoritë e abuzimeve ndaj fëmijëve:

- Fizik, Seksual, Emocional, Neglizhimi, Mendor
- Fizik, Emocional, Trupor, Seksual, Shfrytëzimi
- Fizik, Emocional, Seksual, Neglizhimi, Shfrytëzimi
- Fizik, Trupor, Emocional, Mendor, Neglizhimi

3. Cilat raste të abuzimit ndaj fëmijëve duhen raportuar?

- Rastet të cilat i shohim vetë
- Rastet për të cilat na njofton dikush
- Rastet për të cilat kemi dyshime në bazë të shenjave
- Të gjitha më lart

4. Çfarë pasoja mund të shkaktojë abuzimi tek fëmijët: (shumëfishtë)

- Vështirësi sociale
- Disponim të qëndrueshëm
- Dëmtim të zhvillimit
- Çrregullime mendore
- Lëndime fizike

5. Bazuar në këtë politikë personeli, partnerët, vullnetarët, praktikantët dhe përfaqësuesit e tjerë NUK duhet asnjëherë të: (shumëfishtë)

- Godasin ose në ndonjë mënyrë tjetër fizike t'i sulmojnë apo t'i abuzojnë fëmijët;
- Përfshihen në aktivitet seksual ose të kenë marrëdhënie seksuale me askënd nën moshën 18 vjeç, pavarësisht nga mosha, pëlqimi i viktimës /pëlqimi i prindërve apo të tjerëve;
- Punojnë me fëmijën në prezencë të një personi të rritur;
- Flenë në të njëjtin shtrat me fëmijën me të cilët ata janë duke punuar;
- Lënë derën hapur përgjatë qëndrimit vetëm në dhomë me fëmijën;
- Diskriminojnë, tregojnë trajtim të padrejtë ose diferencial mes fëmijëve të caktuar duke i përjashtuar të tjerët;
- Të qëndrojnë në të njëjtën dhomë vetëm me një fëmijë me derën mbyllur.

6. Personeli, partnerët, vullnetarët, praktikantët dhe përfaqësuesit e tjerë DUHET të: (shumëfishtë)

- Jenë të vetëdijshëm për situatat që mund të paraqesin rrezik dhe t'i menaxhojnë ato;
- Planifikojnë dhe organizojnë punën dhe vendin e punës në mënyrë që të minimizojnë rreziqet;
- Kalojnë kohë të tepërt vetëm me fëmijët, larg nga të tjerët;
- Sigurohen që ekziston një kulturë e hapur për të mundësuar çfarëdo çështjesh apo shqetësimesh të ngrihen dhe diskutohen;
- Bisedojnë me fëmijët rreth kontaktit të tyre me personelin ose të tjerët, në mënyrë që t'i inkurajojnë ata për të ngritur ndonjë shqetësim potencial;
- Qëndrojnë në një ambient/dhomë të mbyllur vetëm me një fëmijë, pa prezencë të të rriturve tjerë;
- Të lënë derën hapur apo të kenë derë/dritare transparente në rast të qëndrimit vetëm me një fëmijë;
- Respektojnë të drejtat e fëmijëve dhe i trajtojnë ata në mënyrë të drejtë, me ndershmëri, me dinjitet dhe respekt.

7. Si duhet të veprojnë një anëtar i stafit në rastet kur është dëshmitar i abuzimit apo merr raportimin nga fëmija? (shumëfishtë)

- Sigurojë mirëqenien imediate të fëmijës në rast nevoje (ambient i sigurt, ushqim, veshmbathje);
- Të mundohet të zgjidhë rastin individualisht pa e përhapur më tutje informatën;
- Ta fshehë rastin dhe të mos e raportojë fare;
- Të përhapë rastin jashtë organizatës;
- Të plotësojë formën e Raportimit për Mbrojtjen e Fëmijës.

8. Sipas Kodit të sjelljes së Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve, personeli, partnerët, vullnetarët dhe praktikantët: (shumëfishtë)

- Nuk duhet të marrin pjesë në asnjë formë të diskriminimit
- Duhet të punojnë më shumë me një fëmijë, familja e të cilit/ës vazhdimisht i sjell dhurata;
- Nuk duhet të marrin pjesë në ndonjë formë të kërcënimit;
- Nuk do të punojnë në mënyrë aktive për të mbrojtur fëmijët:

9. Para çdo aktiviteti me fëmijë jashtë hapësirave të përditshme të punës, është i domosdoshëm plotësimi i formës së vlerësimit të rrezikut:

- E saktë
- E pa saktë

10. Parimet e Politikës për Mbrojtje të Fëmijëve në HANDIKOS janë të vlefshme:

- Çdo herë, si brenda dhe jashtë hapësirave të punës së HANDIKOS për punonjësit e saj;
- Vetëm atëherë kur kërkohet në kuadër të projektit të caktuar;
- Vetëm për punëtorët të cilët janë të përfshirë në punë direkte me fëmijët;

11. Një fëmijë mund ta mbërthejë pullat e bluzës në mënyrë të pavarur, megjithatë ju i mbërtheni ato për të. Kjo është:

- E ndaluar me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve në HANDIKOS;
- Kjo nuk paraqet dëm në shëndetin e fëmijës;
- E lejuar në kuadër të Politikës për Mbrojtje të Fëmijëve në HANDIKOS
- Kjo nuk cenon zhvillimin e fëmijës.

12. Gjatë kohës sa jeni duke qëndruar në hapësirat e HANDIKOS, ju mund ta mbani në prehër fëmijën me të cilin jeni duke punuar. Kjo është:

- E lejuar me Politikë dhe rregulloret e tjera të organizatës;
- E ndaluar me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve